



SPECIFIKIME - TEKNIKE

Objekti : "RIKONSTRUKSIONI I AMBIENTEVE TE REPARTIT TE REANIMACIONIT TE KIRURGJISE SPITALORE VLORE."

PARAQITJE

Ky specifikim teknik është dokument kontraktor, është hartuar nga studio projektuese për "RIKONSTRUKSIONIN E AMBIENTEVE TE REPARTIT TE REANIMACIONIT TE KIRURGJISE SPITALORE VLORE"

Zerat e rradhitur në këtë specifikim, përkojnë me zerat e preventivuar, mbështetur në projektin e hartuar dhe në "Manualët teknike të cmimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre" të miratuar nga K.M i Republikës së Shqipërisë me vendimet e korrikut 2015.

Standartet e cilësive të materialeve të përdorura janë, ato të shtetit Shqiptar për materialet prodhim vendi dhe ato të vendeve të Bashkimit Europian për materialet e importit. Në këto raste Administratori i kontratës vec certifikates së origjinës mund të kërkojë dhe certifikat e cilësive dhe të dhënat për performancën teknike të artikujve që do të furnizohen.

Standartet e përdorura në këtë specifikim teknik, nuk janë mbështetur vetëm në vizatimet e projektit, kushtet teknike të projektimit dhe të zbatimit, por edhe në manualët ligjorë dhe në libra të tjera.

Subjekti i përfshirë në realizimin e objektit të kësaj kontrate, në rast problemi, mund të bëjë sugjerime, përmirësime dhe plotësime të këtyre specifikimeve, nëse kërkohej nga ndryshime të mundshme të kategorive të punimeve ose mungesa e detajeve dhe e materialeve.

TE PERGJITHSHME

Paragrafet në këtë kapitull janë plotësuese të detajeve të dhëna në Kushtet e Kontratës dhe i shërbejnë kontraktorit për fazën e përgatitjes së ofertës dhe supervizorit gjatë fazës së zbatimit. Kontraktori dhe supervizioni duhet të kenë parasysh që :

1. Kontraktori do të verifikojë të gjitha dimensionet, sasitë dhe detajet të treguar në Vizatimet, Grafiket, ose të dhëna të tjera. Punëdhënësi nuk do të mbajë përgjegjësi për ndonjë mangësi ose mosperputhje të gjetur në to. Mos zbulimi ose korrigjimi i gabimeve ose mosperputhjeve nuk do të lehtësojë Kontraktorin nga përgjegjësia për punën të përfunduar. Kontraktori do të marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë në berjen e llogaritjeve të madhësive, llojeve dhe sasive të materjaleve dhe pajisjeve të përfshira në punën që duhet bërë sipas Kontratës. Ai nuk do të lejohet të ketë avantazhe nga ndonjë paqartësi. Rikonstruksioni është kompleks, pasi është kati i sipërm i ndërtës. Ai do të realizohet pa ndërprerje funksionin katet e mëposhtme; po kështu dhe vete kirurgjia do të funksionojë, prandaj rikonstruksioni do të bëhet me zona të cilat do të bashkërendohen me sipërmarresin.



"6D-PLAN" sh.p.k.

NIPT: L62717405H

Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla 3, Kati i Parë, Njësia Nr.7, Tiranë

E-mail: 6d.plan@gmail.com, Nr tel : + 355 456 29 711, Mob: + 355 69 60 66 450

2. Kontraktori duhet te kete parasysh se eshte i detyrura qe te garantoje paprekshmenine e shendetit dhe jetes se punonjesve dhe pacienteve ne katet e meposhtme, ai duhet siguroje kalime te sigurta dhe te mbrojtura. Naterialet dhe mbeturinat nuk do te levizin nepermjet shkalleve te perbashketa por do te behen me cinca dhe vetem ne pika te paracakjuara dhe te parashikuara ne planin e organizimit te punimeve.

3. Kontraktorit nuk do te behet asnje pagese mbi cmimet njesi te kuotuar per kostot e mobilizimit d.m.th. per sigurimin e transportit, drite, energjine ,veglat dhe pajisjet,ose per furnizimin e godines dhe mirembajtjen e impjanteve te ndertimit,rugeve te hyrjes,te komoditeteve sanitare heqje e mbeturinave, punen, furnizimin me uje, mbrojtjen kundra zjarrit, bangot e punes, rojet, rrjetin telefonik si dhe struktura te tjera te perkoheshme, pajisje dhe materjale, ose per kujdesin mjeksor dhe mbrojtjen e shendetit, ose per patrullat dhe rojet, ose per ndonje sherbim tjetër, lehtesi, gjera, ose materjale te nevojshme ose qe kerkohen per zbatimin e punimeve ne perputhje me ate qe eshte parashikuar ne Kontrate.

4. Kontraktori te organizoje punen per ndertimin, mirembajen dhe me pas te spostoje dhe ta rivendose cdo rruge hyrje qe do te duhet ne lidhje me zbatimin e punimeve . Cvendosja do te perfshije pershtatjen e zones me cdo rruge hyrje dhe se paku me shkalle sigurie,qendrushmerie dhe te kullimit te ujrave siperfaqesore te njejte me ate qe ekzistonte perpara se Kontraktori te hynte ne Shesh.

5. Kontraktori ujin qe nevojitet per zbatimin e punimeve do te merret nga rrjeti kryesor nepermjet nje matesi ne piken me te afert te mundeshme. Kontraktori do te shtrije rrjetin e vet te perkoheshem te tubacioneve . Lidhjet me rrjetin kryesor dhe kostot per kete do te pagohen nga Kontraktori. Ne rastet kur nuk ka mundesi lidhje me rrjetin kryesor, Kontraktori duhet te beje vete perpjekjet per furnizimin me uje higjenikisht te paster dhe te pijshem per punetoret dhe punimet.

6. Kontraktori do te beje perpjekjet dhe me shpenzimet e tij per furnizimin me energji elektrike ne kantjer, si me kontraktim me KESH – in , kur lidhjet me rrjetin kryesor lokal jane te mundura , ose duke parashikuar gjeneratorin e vet per te permbushur kerkesat.

7. Kontraktori , me shpenzimet e tij duhet te beje ndertimin e modinave dhe te piketave sic kerkohet, ne perputhje me informacionin baze te Punedhenesit,dhe do te jete pergjegjesi i vetem per perpikmerine. Kontraktori do te jete pergjegjes per te kontrolluar dhe verifikuar informacionin baze qe i eshte dhene dhe ne asnje menyre nuk do te lehtesohet nga pergjegjesia e tij ne se nje informacion i tille eshte i manget, jo autentik ose jo korrekt .
Ai nderkohe do te jete subjekti qe do te kontrollohet dhe rishikohet nga Punedhenesi ,dhe ne asnje rast nuk i jepet e drejta te beje ndryshime ne vizatimet e kontrates , per asnje lloj kompensimi per korrigjimet e gabimeve ose te mangesive .Kontraktori do te furnizojë dhe mirembaje me shpenzimet e tij, rrethimin dhe materiale te tjera te tilla dhe te jape asistenca nepermjet nje stafi te kualifikuar sic mund te kerkohet nga Punedhenesi per kontrollin e modinave dhe piketave.



8. Kontraktori do të ruajë të gjitha pikat e akseve, modinat, shenjat e kuotave, të bera ose të vendosura gjatë punës, të mbulojë koston e rivendosjes së tyre nëse ato demtohen dhe të mbulojë të gjitha shpenzimet për ndreqjen e punës së bërë jo mirë për shkak të mosmirembajtjes ose mbrojtjes ose spostimit pa autorizim të këtyre pikave të vendosura, modinave dhe piketave.

Përpara çdo aktiviteti ndërtimor, Kontraktori do të ketë linjat e furnizimit me ujë dhe energji elektrike të vendosura në terren, të drejten e kalimit të qarte dhe të sheshuar, gati për fillimin e punimeve. Çdo punë e bërë jashtë akseve, kuotave dhe kufijve të treguara në vizatime ose të mosmiratuara nga Punedhësi nuk do të paguhet, dhe Kontraktori do të mbulojë me shpenzimet e tij germimet shtesë gjithmone nën drejtimin e Supervizorit.

9. Kontraktori duhet të bëjë forografi me ngjyra sipas udhëzimeve të Supervizorit në vendet e punës për të demonstruar kushtet e sheshit përpara fillimit, progresin gjatë punës së ndërtimit dhe mbas përfundimit të punimeve. Nuk do të behen pagesa për fotografimin e kantierit të punimeve pasi këto shpenzime janë parashikuar të mbulohen nën koston administrative të Kontraktorit.

10. Kontraktori duhet të ketë vecanerisht kujdes në:

- a) nevojën për të mirembajtur shërbimet ekzistuese dhe mundësitë e kalimit për banorët dhe tërësit që janë në zone gjatë periudhës së ndërtimit.
- b) prezencën e mundshme të kontraktoreve të tjerë në zone me të cilët do të koordinohet puna. E gjithë puna do të bëhet në një mënyrë të tillë që të lejojë hyrjen dhe perballimin e të gjithë pajisjeve të mundshme për ndonjë Kontraktor tjetër dhe punëtorëve të tij, stafin e Punedhësit si edhe të çdo punonjësi që mund të përdoret në zbatim dhe/ose punimet në zone ose pranë saj për çdo objekt që ka lidhje me Kontraten ose çdo gjë tjetër.

Në përgatitjen e programit të tij të punës Kontraktori gjatë gjithë kohës do të bëjë llogari të plote dhe do të koeporojë me programin e punës së Kontraktoreve të tjerë në mënyrë që të shkaktojë një minimum interferencë me ta dhe me publikun. Nga Punedhësi rekomandohet që punëtorët e përkualifikuar të merren nga zona.

11. Kontraktori do të marrë masa paraprake për mbrojtjen e punëtorëve të punësuar dhe të jetës publike si edhe të pasurive në dhe rreth sheshit të ndërtimit. Masat e sigurimit paraprak të ligjeve të aplikueshme, kodeve të ndërtësive dhe të ndërtimit do të respektohen. Makineritë, pajisjet dhe çdo rrezik do të kufizohen ose eliminohen në përputhje me masat paraprake të sigurimit.

12. Kontraktori, gjatë zbatimit të punimeve me shpenzimet e veta, duhet të vendosi dhe të mirembajë gjatë natës pengesa të tilla dhe drita të cilat do të parandalojnë në mënyrë efektive aksidentet. Kontraktori duhet të sigurojë pengesa të përshtatshme, shenja me dritë të kuqe "rrezik" ose "kujdes" dhe vrojtues në të gjitha vendet ku punimet mund të shkaktojnë rregullime të trafikut normal ose që përbejnë në ndonjë mënyrë rrezik për publikun.



13. Kontraktori, me shpenzimet e veta, duhet të ndermarre të gjithë veprimet e mundshme për të siguruar që ambjenti lokal i sheshit të ruhet dhe që vijat e ujit, toka dhe ajri (duke përfshirë edhe zhurmat) të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve të kryera. Mos plotësimi i kësaj klauzole në bazë të evidentimit nga Supervizori, mund të çojë në ndërprerjen e kontratës.

14. Kontraktori transportin e çdo materiali nga kavat, nyjet apo magazinat e ndryshme, do ta bëjë me makina të përshtatshme të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë dërdhje dhe të gjithë ngarkesa të jete të siguruar. Ndonjë makine që nuk plotëson këto kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantieri. Të gjitha materialet, duhet të stivohen ose të magazinohen në mënyrë të përshtatshme për të mbrojtur nga rreshqitjet, demtimet, thyerjet, vjedhjet dhe në dispozicion për tu kontrolluar nga Supervizori në çdo kohë.

15. Kontraktori duhet të bëjë me shpenzimet e tij, të marrë me qira ose të blerë një terren të mjaftueshëm për ngritjen e magazinave dhe zyrave të tij dhe për krijimin e një zyre për Supervizorin siç është specifikuar, të gjitha këto me shpenzimet e tij.

16. Kontraktori duhet të përgatisë vizatimet për të gjitha punimet "siç janë faktikisht zbatuar" në terren. Vizatimet do të behen në një standart të ngjashëm me atë të vizatimeve të Kontratës. Gjate zbatimit të punimeve në kantiër, Kontraktori do të ruajë të gjithë informacionin e nevojshëm për përgatitjen e "Vizatimit siç është zbatuar". Do të shenojë në mënyrë të qartë vizatimet dhe të gjitha dokumentet e tjera, të cilat mbulojnë punën e vazhdueshme të perfunduar, material i cili do të jete i disponueshëm në çdo kohë gjatë zbatimit për Supervizorin. Këto vizatime do të azhurnohen në mënyrë të vazhdueshme dhe do të dorëzohen Supervizorit çdo muaj për aprovim, pasi Punimet të kenë perfunduar, sëbashku me kopjen perfundimtare. Materiali mujor do të dorëzohet në kopje leter.

Vizatimet e riprodhuara do të përfshijnë pozicionin dhe shtrirjen e të gjithë konstruksioneve mbajtëse të lena gjatë germimeve dhe vendosjen ekzakte të të gjithë shërbimeve që janë ndeshur gjatë ndërtimit. Kontraktori, gjithashtu duhet të përgatisë seksionet e profilit gjatësor të rishikuar, pajisur me shenimet që tregojnë shtresat e tokës që hasen gjatë të gjithë punimeve të germimit. Si perfundim, kopjet e riprodhuara të Vizatimeve "siç është zbatuar" do t'i dorëzohen Supervizorit për aprovim. Vizatimet "siç është zbatuar", të aprovuara, do të behen prone e Punedhësit.

Nuk do të behen pagesa për berjen e Vizatimeve "siç është zbatuar" dhe Manualeve, pasi kosto e tyre është parashikuar të mbulohet nga shpenzimet administrative të Kontraktorit. Vizatimet duhet të printohen në format A0, A1, A2, A3 dhe t'i dorëzohen Investitorit në 3 kopje.

17. Kontraktori në perfundim të punës, sa herë që është e aplikueshme, me shpenzimet e tij, duhet të pastrojë dhe të heqë nga sheshi të gjithë impiantet ndërtimore, materialet që kanë tepëruar, mbeturinat, skelerite dhe ndërtimet e perkoheshme të çdo lloji dhe të lere sheshin e tere dhe veprat të pastra dhe në kondita të pranueshme. Pagesa perfundimtare e Kontratës do të mbahet deri sa kjo të realizohet dhe pasi të jepet miratimi nga Supervizori.



A . PUNIME NDERTIMI E RIKONSTRUKSIONI

I. PUNIME PRISHJE

1.Per lirim të sheshtë të ndërtimit nevojitet të prishen veç të tjerave dhe ndërtesa ekzistuese me lartësi kati të ndryshme. Prishje mund të realizohet me mënyra të ndryshme nga ajo me krahe me makineri dhe me lëndë eksplozive. Skemën e përzgjedh kontraktori i cili e parashikon atë kur përcakton mënyrën e prishjes.

1. Prishja e pjesshme ndërtësive me rikuperim material të përfshin:

Të kërkesat e mësipërme të përshkruara :

Zgjedhjen, pastrimin dhe stivimin në vendin e caktuar, për ruajtje të paracaktuar për tu rikuperuar nga prishja, stivimin e materialeve brenda kantierit, ngarkimin të transportit deri në magazinat e investitorit dhe shkarkimin për materialet që nuk do të ripërdoren në objekt.

2. Prishja e mureve me tullë gjithëfaqshme dhe blloqe të përfshin:

Përcaktimin dhe përdorimin e mjetit të përshkruar, në varesi të masës që do të priset; në varesi të trashëgësive të murit dhe të llojit të tullave apo blloqeve që janë përdorur

Prishjen e suvatimit, veshjes së çfarëdo forme, që janë realizuar në murin që priset, pavarësisht nga trashësia e tyre.

Skelenë e shërbimit ose skelerinë, armaturat e nevojshme për të mbështetur ose mbrojtur strukturat ose ndërtesat përreth.

Riparimin për demet e shkaktuara ndaj të treve për ndërprerjet dhe restaurimin normal të tubacioneve publike dhe private (kanalet e ujërave të zeza, ujë, dritat etj.), transportin e tërë materialeve që rezultojnë nga prishja në një vend të autorizuar publik.

Kur kërkohet rikuperimi i tullave apo blloqeve, bëhet dhe pastrimi, stivimin e tyre për ruajtje kur do të ripërdoren ose të dorëzohen në magazinat e investitorit.

Garancinë për punë të sigurta për punonjësit pjesëmarrës në proces të kalimtarëve dhe të komunitetit.

3. Heqja e arkiturave të përfshin:

Përcaktimin, pas verifikimit të situatës, të rrëzimit të punës dhe të masave mbrojtëse, për konstruksionin dhe skelerinë për punonjësit. Masat mbrojtëse për konstruksionin të përfshijnë puntelimet e nevojshme për mbajtjen e soletave apo mureve mbi to.

Prishjen e muraturës sipër tryre deri në nivelin e soletës me të afërt, për të gjithë gjerësinë e muraturës mbi arkitrën, të mbështetësive dhe gjatësinë 25 cm matane hapësirës së dritës (nga të dyja anët), spostimin e materialit që rezultojnë brenda ambientit të kantierit, dhe çdo detyrim tjetër për të dhënë fund heqjes.

Garancinë për punë të sigurta për punonjësit pjesëmarrës në proces të kalimtarëve dhe të komunitetit.



"6D-PLAN" sh.p.k.

NIPT: L62717405H

Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla 3, Kati i Parë, Njësia Nr.7, Tiranë

E-mail: 6d.plan@gmail.com, Nr tel : + 355 456 29 711, Mob: + 355 69 60 66 450

4. Prishja e shtresave hidroizoluese ne teraca perfshin:

Prishje e shtreses mbrojtëse të hidro - izolimit të terraces me zhvillime vertikale, edhe në praninë e oxhaqeve, pa demtuar katramanë pasi ajo do të shfrytezohet si bazament për shtresat e guajnes të hidroizolimit të ri. Kjo bëhet pasi ngjitja e guajnes se pare bëhet me ngrohje dhe siguron ngjitje të mirë. Është në të drejtë të kontraktorit që të mos i shfrytëzojë këto shtresa por ai është detyruar ta parashikojë këtë heqje në cmimin që do të paraqesë në tender. Kontraktorit nuk i njihet e drejta të ndryshojë këtë proces me kërkesën për shtesë fondi.

Prishje e suvasë në sipërfaqet vertikale deri në një lartësi të pakten 30 cm , deri në dalje në dukje të muratës , për vendosjen e guajnes.

Prishje e suvasë në parapete dhe sipërfaqet vertikale deri në një lartësi të pakten 30 cm , deri në dalje në dukje të muratës , për vendosjen e guajnes.

Garancinë për punë të sigurta për punonjësit pjesëmarrës në proces të kalimtareve dhe të komunitetit.

5. Prishja e shtresave, veshjeve të shkalleve, dërmimeve dhe ilustrave perfshin:

Prishjen e shtresave të dyshemeve, veshjeve të shkalleve, dërmimeve të dritareve dhe ilustrave dhe trotuareve kur ajo kërkohej ; pamvarësisht nga mbistresa pllaka granili, betoni gres , mermer , parket etj.

Prishjen e shtresës së Llaçit, të kolles apo nënstrukturat e shtresave të parketit dhe spostimin e materialeve që rezultojnë nga prishjet ; pa demtuar bazamentin e tyre e vecanërisht murin në rastin e dërmimeve dhe shtresat e katramanë në rastin e terracave.

Dërmimin e atyre pjesëve të materialeve që në preventiv është parashikuar të rikupërohet duke i depozituar apo transportuar në vendin ku cakton investitori nëpërmjet supervisorit. Materialet që kërkohej të rikupërohen do të dërmohen me proces verbal.

Çdo detyrim tjetër për mbarimin e plote dhe shqepjes së shtresës të dyshemëve dhe garancinë për punë të sigurta për punonjësit pjesëmarrës në proces të kalimtareve dhe të komunitetit në mënyrë perfekte.

Garancinë për punë të sigurta për punonjësit pjesëmarrës në proces të kalimtareve dhe të komunitetit.

6. Prishja e suvatimeve dhe veshjeve perfshin:

Kontrollin me goditjen e të gjithë tre sipërfaqes së suvatuar dhe përcaktimin e pjesëve të mufatura dhe të plasaritura , për rastin kur prishja nuk është përcaktuar të kryhet në 100% të sipërfaqeve.

Heqjen e plote ose të pjesshme të suvatimeve të soletave, të mureve dhe të fasadeve, deri në bazamentin beton, gure, tullë bllok, pamvarësisht nga trashësia e shtresës të kryer me çfarëdolloj mjeti dhe e çfarëdo lartësie ose thellesie, skelen e shërbimit ose skelerinë, armaturat e mundshme për të mbështetur ose mbrojtur strukturat ose ndërtesat përreth, pa i demtuar ato.

Pastrimi i sipërfaqeve të prishura nga mbeturinat dhe larja me ujë të bollshëm me presion.

Garancinë për punë të sigurta për punonjësit pjesëmarrës në proces të kalimtareve dhe të komunitetit.



"6D-PLAN" sh.p.k.

NIPT: L62717405H

Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla 3, Kati i Parë, Njësia Nr.7, Tiranë

E-mail: 6d.plan@gmail.com, Nr tel : + 355 456 29 711, Mob: + 355 69 60 66 450

7. Heqja e dyerve dhe dritareve perfshin:

Heqjen e dyerve dhe dritareve te çfarëdo lloji, dhe te cfardo permase, perfshire kasen, telajot, etj.

Dorezimin e tyre sic parashikohet ne preventiv , pa i demtuar ato dhe paturat e dritareve dhe shpatullave te dyerve.;

Depozitim apo transportin ne vendin ku cakton investitori nepermjet supervizorit.

Dyert dhe dritaret qe kerkohet te rikuperohen do te dorezohen me proces verbal.

Garancine per pune te sigurte pet punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

8. Heqja e instalimeve elektrike perfshin:

Shkeputjen e burimit te udhqimit te sistemit ne menyre te sigurte , heqje pjeseve qe preventivi parashikon te rikuperohen sic jane ndricuesit dhe paisjet e ndryshme, dorezimin e tyre sic parashikohet ne preventiv ; duke i depozituar apo transportuar ne vendin ku cakton investitori nepermjet supervizorit.

Heqjen e te gjithë kabllove elektrike dhe tubave plastike, kutive, kuadrove, prizave, celesave elektrike, etj, ekzistuese, brenda ose jashte mureve te godines.

Transportimin ne nje vend public te mbetjeve nga prishjet . Riperdorimi i materialeve nuk lejohet ne asnje rast.

Pergjegjsine e kontraktorit , per cdo demtim shkaktuar punimeve te ndertimit per mos heqjen e kabllove, tubave plastike, kutive, kuadrove, prizave, celesave elektrike te vjeter etj, dhe mos eliminimin e duhur te demeve.

Garancine per pune te sigurte pet punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

9. Heqja e instalimeve hidrosanitare dhe te ngrohjes perfshin:

Shkeputje e linjes te udhqimit te sistemit ne menyre te sigurte , heqje aparateve qe preventivi parashikon te rikuperohen sic jane bojleret, kondicionerte e paisjet e ndryshme, dorezimin e tyre sic parashikohet ne preventiv ; duke i depozituar apo transportuar ne vendin ku cakton investitori nepermjet supervizorit.

Heqja e aparateve hidrosanitare WC, Bide Lavaname ,Pllaka dushi duke i nxjere jashte objektit e duke i transportuar brenda dites per ne vendin e caktuar nga Bashkia. E njejta praktike pune do te ndiqet dhe me tubacuobet e shkarkimit te ujrave te zeza. Dalohet reptesisht riperdorimi i tubove te shkarkimit te ujrave te zeza.

Heqjen e rrjetit te brendshme te furnizimit me uje , largimi i tyre ne depoziten e materialeve, nuk konsiderohen te kontaminuar.

Heqje e te gjithë tubave ekzistues te ngrohjes jashte mureve te godines, deri ne piken e ngrohjes qendrore, te radiatoreve ku ekzistojne ne tere godinen, dhe kaldajes ne dhomen e ngrohjes.

Vendosjen e kaldajes , ne nje zone te mbrojtur te Kantjerit, ne dispozicion te Administratorit te Kontrates, deri ne perfundim te punimeve te ndertimit. Nese nuk hiqet nga Administratori i Kontrates, ne perfundim te punimeve ajo do te spostohet dhe transportohet ne nje vend te autorizuar publik nga Kontraktori, i cili do ta lere Kantjerin plotesisht te pastruar. Riperdorimi i tubave nuk lejohet ne asnje rast.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.



10. Transport dhe e mbeturina ndertimi me auto perfshin:

Ngarkimin ne mjet, me makineri apo me kjahe , te materialet e nxjera nga germimi i dherave te themeleve, mbeturina e ndertimit dhe dergimin e tyre ,ne vendin e caktuar nga Bashkia.

II.PUNIME MURATURE

1. Llacet perfshin:

Sigurimin e materialit lidhes (Llacit) sipas llojit:

Llaç bastard marka 15 me rërë të larë (porozitet 35%) e formuar me, çimento, gelqere, rërë ne raportë 1: 0,8: 8. Gelqere e shuar lt 105 , çimento 300 kg 144 , rërë m³ 1,03 .

Llaç bastard marka 25 me rërë të larë (porozitet 35 %) e formuar me , çimento: gelqere, rërë ne raportë 1: 0,5: 5,5. Gelqere e shuar lt 87 , çimento 300 kg 206 , rërë m³ 1,01 .

Llaç bastard marka 1:2 me rërë të larë (porozitet 35%) e formuar me çimento, rërë ne raportë 1:2. Çimento 400 kg 527 , rërë m³ 0,89.

2 .Muraturat prej tulle perfshin:

Tulla të plota, Llaç bastard m-25 ,per murin me tulla te plota me dozim per m³: tulla të plota nr.400, Llaç bastard m3 0.25, çimento 400 kg 38, për çdo trashesi, duke perfshire çdo detyre dhe mjeshteri për dhembët e lidhjes, qoshet, parmaket , skelat e sherbimit ose skelerine si dhe çdo gje tjeter te nevojshme per mbarimin e muraturës dhe realizimin e saj ne menyre perfekte. Per muraturen e katit perdhe siperfaqja e themelit duhet te jete e niveluar me nje Shtresë Llaçi çimento 1:2 me trashesi 2 cm.

Tulla të lehtësuara, Llaç bastard m-25 pr murin me tulla te lehtësuara , me doze per m³ : tulla të lehtësuara nr.205, Llaç bastard m3 0.29, çimento 400 kg 44, për çdo trashesi, duke perfshire çdo mjeshteri për dhembët e lidhjes, qoshet, hapjet ne parapetet e dritareve, skelat e sherbimit ose skelerine si dhe çdo gje tjeter te nevojshme per mbarimin e muraturës dhe realizimin e saj ne menyre perfekte. Per muraturen e katit perdhe siperfaqja e themelit duhet te jete e niveluar me nje Shtresë Llaçi çimento 1:2 me trashesi 2 cm.

Tulla te plota, per formimin e dy mureve anesore me trashesi 12 cm dhe koridor ajri ne mes me trashesi 11 cm llac bastard m-25 me dozim per m³: tulla te plota nr. 404, llac m3 0,19, cimento 400 kg 29 dhe uje. Muret anash jane te lidhur nga brenda njeri me tjetrin cdo afersisht 180 cm me mur te te njejtit tip dhe sipas udhezimeve te projektit, perfshire cdo mjeshteri per dhembet e lidhjeve, qoshet, hapjet ne parapetet e dritareve, skelat e sherbimit dhe cdo gje tjeter te nevojshme per mbarimin e muratures dhe realizimin e saj ne menyre perfekte. Per muraturene e katit perdhe siperfaqja e themeleve duhet te jete e niveluar mire me llac cimento 1:2.

Tulla me bira , per formimin e dy mureve anesore me trashesi 12 cm dhe koridor ajri ne mes me trashesi 11 cm llac bastard m-25 me dozim per m³: : tulla me 6 bira nr. 177, llac m3 0,10, cimento 400 kg 14 dhe uje. Muret anash jane te lidhur nga brenda njeri me tjetrin cdo afersisht 180 cm me mur te te njejtit tip dhe sipas udhezimeve te projektit, perfshire cdo mjeshteri per dhembet e lidhjeve, qoshet, hapjet ne parapetet e dritareve, skelat e sherbimit dhe cdo gje tjeter te nevojshme per mbarimin e muratures dhe realizimin e saj ne menyre perfekte. Per muraturene e katit perdhe siperfaqja e themeleve duhet te jete e niveluar mire me llac cimento 1:2.



3. Montim profia metalik per formimin e arkitrareve , perfshin:

Arkitrau me profil metalik eshte perdorur ne rastin kur nje dritare zmallohet duke perfshire dy apo me shume dritare ekzistuese. Para se te behet prishja e mureve ndermjet dritareve qe do te hiqen , montohet arkitrau i ri i cili ne rastin konkret eshte m. Per te mos krijuar problem teknike dhe per te mos rezikuar shendetin dhe jeten e punonjesve qe do te meren me kete process, te kalimtareve inxhinieri i objektit duhet te planizojë punen dhe te percaktojë radhen e punes qe ne rastin konkret eshte parashikuar.

Arkitrarau i ri ne muret me trashesi mbi 25 cm nderohet me dy faza:

- a. vendoset arkitrau i ri, ne nje ane dhe vetem pasi te jete ndertuar e staxhionuar plotesisht ai dhe te njeri krah kalohet ne.
- b. Vendosjen e arkitraut ne krahun tjeter dhe vetem pas kesaj mund te kalohet ne zgjerimin e dritares apo ne bashkimin e tyre nepermjet prishjes se mureve apo te nje pjese te tyre.

Puna per vendosjen e arkitraut te krahut te pare, i cili vendoset nga vete zbatuesi i punimeve, fillon vetem pas ndertimit te skeleve te nevojshme, te qendrushme dhe realizohet sipas radhes se me poshtme:

a. hapet ne mur nje kanal sa gjysma e trashesise se tij me lartesi + 2-3 cm lartesine e profilit metalik. Nese arkitrau i ri eshte ne nje nivel me arkitraret ekzistues, hiqet dhe arkitrau parafabrikat ekzistues.

b. nivelohen mbeshtetjet e profilit me llac granili ne kuoten e percaktuar ne projekt.

c. mbushen hapsirat ne mbeshtetje dhe ato mbi profilin metalik, me kujdes, me llac granili, minimumi 48 ore pas ketij procesi apo sipas vendimit te drejtusit te punimeve, artitrau eshte i gatshem te mbaje ngarkesen c'ka mundeson kalimin ne krahun tjeter.

Pasi pasi te kete perfunduar montimi i profikave edhe ne krahun tjeter , dhe pasi te jete staxhionuar ai ; mund te kalohet ne zgjerimin e shpatullave te dritares sipas projektit apo nr prishjen e mureve ndermjet dritareeve qe do te zgjerohen.

Pasi te jene zgjeruar dritaret mund te lakalohet ne shpetullimin e tyre c'ka reaslizohet duke i veshur ato me rrjete teli xingato me $t=1$ mm e duke i mbushur me llac granili.

Gjithcka realizohet sipas udhezimeve te inxhinierit te objektit, duke perfshire, puntelimet, skelen e sherbimit, punimet e mundshme me murature etj., cdo gje tjeter te nevojshme per perfundimin e perforcimit dhe realizimin e tij ne menyre perfekte duke siguruar garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

4. Mure karton xhesi perfshin:

Ndertimin mureve ndares me karton xhes sipas vizatimeve ne projekt, i veshur nga te dy anet me pllaka k/xhesi me trashesi 12 mm i mberthyer ne konstrukcion metalik special dhe te prodhuar posacerisht per knauf. dhe i mbushr ne mes me pambuk mineral i

Ne lidhjet e tabakeve te karton xhesit dhe ne qoshe do te perdoret detyrimish rrjet nejloni e pozacme per te menjanuar plaseritjet.

Cdo detyrim tjeter per mbarimin e plote e te sigurte te shqepjes ne menyre perfekte.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.



"6D-PLAN" sh.p.k.

NIPT: L62717405H

Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla 3, Kati i Parë, Njësia Nr.7, Tiranë

E-mail: 6d.plan@gmail.com, Nr tel : + 355 456 29 711, Mob: + 355 69 60 66 450

III .PUNIME SHTRESASH

1. Shtres dysHEME me pllaka gras perfshin;

Pllakat do te jene te dimensineve 31.6x31.6 , gres porcelanato nje brumeshe, jo luçidato Ngjyra e tyre do te percaktohet nga supervizori. Pllakat do te jene «zgjedhje e pare» te verifikuara ne amballazhim. Pllakat do te shrohen me kolle, mbi nje siperfaqe grezo me llaç çimento pasi te jete verifikuar nivelimi i saj me nje proces verbal. Nivelimi te behet nga nje specialist topograf me nje tolerance jo me shume se 5mm ne te gjithe godinen. Pllakat do te shtrohen me fuga qe formojne nje kend 45 grade me akset e godines. Akset diagonale te pllakave duhet te jene rigorozisht paralele me akset e godines dhe shtrimi i tyre duhet te jete pa nderprerje nga koridori neper dhoma, pra fugat te jene ne vazhdimesi.

2. Vendosje e plintusave perfshire

Zokol plintusi ne qeramike me ngjyre te erret me lartësi 8 cm dhe trashesi 1,5 cm , i vendosur në vepër kolle duke perfshire stukimin, pastrimin si dhe çdo detyrim tjeter per mbarimin e plote te punes ne menyre perfekte.

V. PUNIME SUVATIMI E VESHJE

1. Suvatime te brendshme ne rikonstruksione prfshin:

Sistemim i siperfaqeve ku eshte e nevojshme, per suvatime per nivelimet e parregullsive me ane te mbushjes me llac bastard me me shume shtresa dhe copa tullash n.q.s. eshte e nevojshme, edhe per zonat e vogla si dhe cdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund stukimit.

Sprucim i mureve dhe tavaneve per murature te pastruar, me llac cimentoje te lenget per permiresimin e ngjitjes se suvase dhe rforcimin e siperfaqeve te muratures, duke perfshire skelat e sherbimit dhe cdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund sprucimit.

Suvatim i realizuar nga nje shtrese me trashesi 2 cm llaci bastard m-25 me dozim per m2 : rere e lare m3 0,005, llac gelqereje m-1:2 m3 0.03, cimento 400 kg 6.6, uje, i aplikuar, me paravendosje te drejtuesve ne mure, dhe e lemuar me mistri e berdaf, duke perfshire skelat e sherbimit si dhe cdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund suvatimit ne menyre perfekte.

2. Veshje me pllaka majolike perfshin:

Veshje per nje lartësi 2 m te mureve , ose sic percaktohet ne projekt, me pllaka majolike te bardha 20x20 cm te cilesise se pare, furnizuar dhe vendosur ne veper mbi nje siperfaqen e pergatitur me pare, e ngjitur me llac me dozim ne m2 : rere e lare m3 0,005, cimento 400 kg 4, stukim me cimento te bardhe, pastrim i plote, skelat e sherbimit si dhe cdo detyrim tjeter per mbarimin e veshjes ne menyre perfekte.

3.Tavanet me karton xhesi perfshin:

Ndertimin tavaneve me karton xhes sipas vizatimeve ne projekt, me pllaka k/xhesi me trashesi 9 mm i mberthyer ne konstrukcion metalik special dhe te prodhuar posacerisht per knauf. Ne lidhjet e tabakeve te karton xhesit dhe ne qoshe do te perdoret detyrimish rrhet nejloni e pozacme per te menjanuar plaserithjet

Cdo detyrim tjeter per mbarimin e plote e te sigurte te shqepjes ne menyre perfekte.

Garancine per pune te sigurte pet punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.



4. Punime patinimi perfshin :

Patinature muri apo tavani , me gelqere te cilesise se larte, mbi siperfaqe te suvatuara me pare dhe te niveluara, me doze: gelqere 3 KG per m2, ose me stuko industruiale. Lartesia e patinaturave per koridoret duhet te vendoset nga Administartori i Kontrates, perfshire dhe cdo pune tjeter dhe kerkese per ta konsideruara patinaturen te perfunduar ne nje menyre te perkryer dhe te gatshme per lyerje me boje vaji.

IV. PUNIME BOJATISJE

1. Lyerje me boje vaji perfshin :

a-Ne rikonstruksione

Gerryerja dhe heqja e lyerjeve te vjetra etj..edhe me shume shtresa mbi dyert dhe dritaret prej druri, mbi patinime ekzistuese si dhe siperfaqe hekuri : siperfaqe druri dhe patinature (me solvent ose flake, me dore ose paisje te mekanizuar), siperfaqe metalike (me solvent, me dore ose paisje te mekanizuar), duke perfshire skelat e sherbimit ose skelerine si dhe spostimin e materialit qe rezulton brenda ambientit te kantierit.

Stukim dhe lemim te dritareve prej druri, patinimeve dhe elementeve prej hekuri me stuko te pershtatshme per pergatitjen e siperfaqeve per lyerjen me boje vaji.

Lyerje e elementeve prej hekuri, me boje te pergatitur me nje dore minio plumbi ose me antiruxho ne forme e vajit sintetik, me dozim per m2 kg 0.080.

Lyerje me boje vaji sintetik, per siperfaqe druri, metalike dhe patinime, me dozim per m2: boj vaji kg 0,2 dhe me shume duar per te patur nje mbulim te plote dhe perfekte te siperfaqeve si dhe cdo gje te nevojshme per mbarimin e plote te lyerjes me boje vaji ne menyre perfekte.

b. Ne ndertimet e reja

Stukim dhe lemim te dritareve prej druri, patinimeve dhe elementeve prej hekuri me stuko te pershtatshme per pergatitjen e siperfaqeve per lyerjen me boje vaji.

Lyerje e elementeve prej hekuri, me boje te pergatitur me nje dore minio plumbi ose me antiruxho ne forme e vajit sintetik, me dozim per m2 kg 0.080.

Lyerje me boje vaji sintetik, per siperfaqe druri, metalike dhe patinime, me dozim per m2: boj vaji kg 0,2 dhe me shume duar per te patur nje mbulim te plote dhe perfekte te siperfaqeve si dhe cdo gje te nevojshme per mbarimin e plote te lyerjes me boje vaji ne menyre perfekte.

4. Lyerje ne rikonstruksione perfshin :

Gerryerja dhe heqja e lyerjeve te vjetra etj..edhe me shume shtresa mbi dyert dhe dritaret prej druri, mbi patinime ekzistuese si dhe siperfaqe hekuri : siperfaqe druri dhe patinaturë (me solvent ose flake, me dore ose paisje te mekanizuar), siperfaqe metalike (me solvent, me dore ose paisje te mekanizuar), duke perfshire skelat e sherbimit ose skelerine si dhe spostimin e materialit qe rezulton brenda ambientit te kantierit.



"6D-PLAN" sh.p.k.

NIPT: L62717405H

Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla 3, Kati i Parë, Njësia Nr.7, Tiranë

E-mail: 6d.plan@gmail.com, Nr tel : + 355 456 29 711, Mob: + 355 69 60 66 450

Stukim dhe lemim te dritareve prej druri, patinimeve dhe elementeve prej hekuri me stuko te pershtatshme per pergatitjen e siperfaqeve per lyerjen me boje vaji.

Lyerje e elementeve prej hekuri, me boje te pergatitur me nje dore minio plumbi ose me antiruxho ne forme e vajit sintetik, me dozim per m2 kg 0.080.

Lyerje me boje vaji sintetik, per siperfaqe druri, metalike dhe patinime, me dozim per m2: boj vaji kg 0,2 dhe me shume duar per te patur nje mbulim te plote dhe perfekte te siperfaqeve si dhe çdo gje te nevojshme per mbarimin e plote te lyerjes me boje vaji ne menyre perfekte.

VI . PUNIME DYER DRITARE

1. F.V dyer te brendshme druri pefshin :

Furnizim dhe vendosje dyersh, permasat e se ciles duhet te percaktohen nga ndermarja ne kantier, ne dru pishe te stazhonuar ne menyre natyrale ose artificiale, i imprenjuar, e ndertuar nga : nje kase ne dru pishe te staxhionuar ne menyre natyrale ose artificiale me trashesi 3 cm, i imprenjuar, me permasa sipas gjereses se muratures dhe e fiksuar ne takot prej druri te paravena ne murature; dere e formuar me kornize me seksion minimal 10x4 cm e lidhur ne fasho ndermjatese orizontale dhe nje vertikale me seksion te njejte dhe fasho te poshtme me lartesis cm 20, duke formuar 3 korniza me dru pishe te staxhionuar ne menyre natyrale ose artificiale me trashesi cm 3, i imprenjuar, i kompletuar me te pakten dy mentesha prej 16 cm secila, nje brave metalike me celes automatik me 3 celesa, doreza alumini dhe piastrat e gojezat perkatese alumini, duke perfshire punime murature, skelat e sherbimit si dhe cdo detyrim dhe punim tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

2. F.V dyer d/alumini perfshin :

Dyert e brendshme Proj duralumini do te perbehen nga:

Kasa fikse në formë profilesh tubolare prej duralumini me thellësi 61-90 mm, te chat sigurohen me elemente te posaçëm per fiksimin dhe mberthimin ne strukturat e mureve. Profilet fikse te kases do te jene me nje mbulesë jo me e vogel 25 mm larg murit.

Kanata lëvizëse ne formë profili duralumini me një thellësi prej 32 mm dhe një lartesi prej 75 mm i rrafshët ose me zgjidhje ornamentale. Profili duhet te jetë me nje hapësire qendrore qe nevojitet per futjen e bashkuesve të qosheve (me hapësirë prej 18 mm per

Instalimi i dyerve të brendshme prej duralumini te dhëna në Vizatimet Teknike, dimensionet e të cilave jepen nga Porositësi, do të bëhen me anë të montimit të profileve të duralumini (komiza ftkse dhe komiza lëvizëse) sipas standartit European EN 573 - 3 dhe të Iyer, kur të jenë përfunduar suvatimet e shpatullave ose vendosur veshjet me pllaka mermer etj. Të dyja pjesët (ftkse dhe lëvizëse) duhet të jenë te projektuar per të bërë dyer që thyejnë nxehtësinë dhe të jene me cily profile duralumini, te cilat bashkohen me një tjetër me anë të dy shiritave hidroizolues gome ose me material plastik.

Një kasë solicie duhet të fiksohet me kujdes me anë te vidave të hekurit në mur dhe në brendësi te llaçit të cimentos. Fiksimi duhet të ketë një distance prej qosheve jo me tepër se 150 mm dhe ndërmjet pjeseve fiksuese jo me tepër se 800 mm. Kasat fikse të dyerve do te bashkohen me kornizat pasi te kete përfunduar suvatimi dhe lyerja. Mbushja e boshlleqeve bëhet me material plastiko elastik dhe pastaj bëhet patinimi i tyre duke perdorur fino patinimi.

Të gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e kasave ti dyervi ne objekt duhet ti bihen sipas kerkesave teknike ti supervizorit dhe të projektit.



"6D-PLAN" sh.p.k.

NIPT: L62717405H

Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla 3, Kati i Parë, Njësia Nr.7, Tiranë

E-mail: 6d.plan@gmail.com, Nr tel : + 355 456 29 711, Mob: + 355 69 60 66 450

3. F.V dyer d/alumini per Wc perfshin :

Furnizim dhe vendosje ne veper dyer te brendshme, permasat e percaktuara ne projekt, te perbera nga:

Nje kontratelajo me tuba metalik xingato, qe do te fiksohet mire ne mure me fasheta te pershtatshme hekuri (cdo 1 m) dhe me llac cemento.

Nje telajo alumini, qe do te vidhoset ne kontratelajo pas punimeve te suvatimit dhe bojatisjes.

Sipas vizatimit te deres ne V.T., telajoja do te pajiset me mentesha dhe bllokuese per instalimin e kanateve te deres.

Kanat dere me profile standarte alumini dhe nga brenda me panel druri te bilaminuar min. 10 mm te trasheshe.

Brava e zakonshme, doreza tunxhi ose plastike , dhe piastrat e gojezat perkatese dhe shum nga mbrapa.

Buke perfshire punimet e rifinitures ne murature si dhe cdo paisje tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte .

Kampione te artikujve te propozuar do t'i paraqiten Supervizorit te Kantjerit per aprovim paraprak.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

4. F.V dritare vetrata d/alumini perfshin:

Cdo grup kryesor dritaresh do te kete Fleten e Garancise se prodhimit. Ne vend te fletes se prodhimit do te pranohen certifikatat e provave te cilat vertetojne se blloqet e dritareve jane sipas kerkesave, duke perfshire dhe proven e mases.

Kerkesat per mostrat e finicionit si dhe ngjyra e bojës duhet te jene te miratuara.

Paraqitet nje pjese dritareje nga çdo tip i propozuar per perdorim e kompletuar me etiketen, pjesen e xhamte, pjesen metalike, dorezat dhe detajet e tjera. Ne rast se jane kerkuar rrjeta teli ose fashatura, atehere mostrat e dritareve pershtaten dhe me keto artikuj. Mbas miratimit, çdo moster vendoset ne funksionim, verifikohet qarte dhe rregjistrohet.

Shperndahen dritaret ne sheshin e ndertimit ne gjendje te pademtuar. Duhet bere kujdes gjate ngarkim-shkarkimit dhe ngjitje-zbritjes si dhe gjate transportit per ne sheshin e ndertimit.

Magazinohen dritaret dhe pjeset perberese jo ne kontakt me token, te izoluara nga agjentet atmosferike me qellim qe te ndalohet shtremberimi, perkulja ose efekte te tjera te cilat mund te demtojne dritaret. Dritaret e demtuara duhet te riparohen dhe behen si te reja ose ne rast te kundert ato nuk duhet te perdoren por duhet te porositen dritare te reja.

Mbrohet sipërfaqja e luciduar gjate transportit sipas metodës standarte te fabrikes, pervec rastit kur dritaret nuk jane lyer pasi perberesit e xhamit mund te ngjisin.

Prodhimi i dritareve te aluminit do te behet ne perputhje me:

Montimi i xhamave do te behet me dy shtresa xhami me trashesi jo me te vogla se 4 mm me hapsire dehidratuese midis tyre dhe te ngjitura hermetikisht. Hapsira midis xhamave do te jete 6 mm. Gjate montimit te xhamave lejohet nje minimum 3 mm hapsire midis xhamit dhe pjeseve metalike e cila do te sherbeje per elementet ngjites dhe per zberthim.

Merren masa qe seksionet e kanateve te hapshe me te gjithë dritareve te arrijne kerkesat e specifikuara per isolimin ndaj kushteve te motit.



"6D-PLAN" sh.p.k.

NIPT: L62717405H

Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla 3, Kati i Parë, Njësia Nr.7, Tiranë

E-mail: 6d.plan@gmail.com, Nr tel : + 355 456 29 711, Mob: + 355 69 60 66 450

Sigurohen fashatura te fabrikuara dhe qe zhvendosen lehtesisht. Perdoren fashatura vinili, i profiluar ose kaucuk sintetik i profiluar - i hapur ose etilen i profiluar Nuk perdoren fashatura kaucuku sintetik dhe polivinilkloridi ne ato raste kur ato jane te ekspozuara direkt ne diell. Perdoren fiksues njelloj me standartin e prodhimit te dritareve dhe aksesoreve te ndryshem. Nuk lejohet perdorimi i vidave vetefiletuese metali te holle ne rast se materialet jane me trashesi jo me te madhe se 2 mm 1/16 inch.

Hapen vrima ne pjeset e siperme te superluceve. Ne rast se dritaret e fiksuara jane te pajisura me superluce, vrimat per shkarkimin e ujit duhet te jene ne maje te dritareve te fiksuara. Merren masa qe vrimat e shkarkimit te jene hapur sipas kerkesave me qellim nxjerrjen e ujit jashte. Dritaret e perdorura me kombinim (dritaret e kombinuara) do te jene te te njejtut kualitet me llojet e tjera te dritareve dhe do te jene te montuara ne fabrike. Atje ku montimi ne fabrike i dritareve individuale ne grupe me te medha eshte i kufizuar nga rrethanat e transportit, parafabrikimit etj. do te behet montimi i tyre ne vend.

Sigurohemi qe elementet e terthorte midis grupeve te dritareve paralele kane plotesuar kerkesat ne lidhje me ngarkesat.

Provojme kanatet me goditje strukture termike. Sigurohemi qe kanatet dhe elementet e terthorte si dhe grupet e dritareve jane vendosur ne menyre te tille qe te formojne nje lidhje te qendrueshme persa i perket kushteve te motit.

Merren masa qe dritaret te pajisen me te gjitha elementet e nevojshem per montim si ato metalike, daret, fiksuesat dhe aksesore te tjere te cilet do te bejne te mundur montimin e dritareve dhe venien e tyre ne funksionim. Se bashku me çdo grup dritaresh duhet te jepen dhe dorezat prej alumini ose prej celiku te galvanizuar

Karakteristikat per tipin, anen funksionale etj. do te jene sipas standartit te prodhuesit per çdo tip te vecante dritareje. Sigurohemi qe keto elemente jane te pershtatur sipas llogaritjeve dhe kryejne sic duhet funksionin per te cilin perdoren. Pajisen te gjitha kanatet me aksesore mbylles per t'i siguruar nga ambienti i jashtem.

Sigurojme fiksues te tipit te rekomanduar nga prodhuesi i dritareve çdo tip specifik te konstruksionit. Mberthyesit dhe fiksuesit duhet te jene te pershtatshem me dritaren dhe me elementet fqinje. Vendosen tre fiksues (mentesha) dy ne skaje dhe nje ne mes.

Veshje anodike (dritare alumini): Siperfaqet e ekspozuara te aluminit do te jene te veshura (lyera) ne fabrike me nje veshje anodike dhe me ngjyre sipas kerkeses. Te gjitha dritaret do te kene te njejten ngjyre. Perpara lyerjes pastrohen te gjitha siperfaqet. Shtresa e finicionit do te kete nje trashesi 0.01 deri 0.0175 mm.

Per dritaret te cilat kane paisje metalike vepruese si celesa, mbyllesa automatike etj. dhe qe jane te vendosura 1800 mm mbi dysheme, sigurohemi qe te gjitha keto paisje jane te vendosura si duhet per te patur nje funksionim sa me te mire te dritareve.



VII . PUNIME TE NDRYSHME

1. Hidroizolimi i dysHEMEVE:

Shtresë hidro-izolimi për të gjitha dyshemete e katit perdhe si dhe të banjove, e përbërë nga një Shtresë emulsioni të bituminuar dhe dy shtresa bitumi M-3 me $3,8 \text{ kg} / \text{m}^2$, dhe e zbatuar në të nxehtë, duke përfshirë çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës në mënyrë perfekte.

Shtresë hidro-izolimi për paretet vertikale të themeleve, e përbërë nga një Shtresë emulsioni të bituminuar dhe dy shtresa bitumi M-3 me dozim $3,8 \text{ kg} / \text{m}^2$, dhe e zbatuar me të nxehtë, duke përfshirë çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës në mënyrë perfekte.

VII . PUNIME ELEKTRIKE

a. Impianti elektrik duhet të zbatohet sipas :

- përmasave, markes, karakteristikave dhe cilësive të materialit të treguar në projektet e hartuara;
- udhëzimeve të D.R. gjatë kryerjes së punëve ;
- respektimit të ligjeve në fuqi ;

Materialët dhe aparatet që duhet të përdoren në ndertimin e impiantit duhet të kenë të gjitha cilësitë e fortësive, kohezgjatjes, izolimit dhe të funksionimit të mirë; dhe duhet gjithashtu të jenë të tilla që ti rezistojnë veprimeve mekanike, gërryese, termike dhe lageshtisë për ato që duhet të jenë në kontakt me të gjatë punës.

Gjithashtu, janë nën përgjegjësi të sipërmarresit montimet dhe demontimet përkatëse të pjesëve të instalimit për realizimin e provave dhe të verifikimeve.

Të gjitha aparatet, kuadrot, centralet e inkasuar, çelësat, butonat, prizat etj., duhet të vendosen në vepër nëpërmjet kutive të instaluar me Llaç çimentoje m-1:2, me dozim për m^2 :

çimento 400 kg 527, rërë e lare m^3 0.89 dhe uje, duke u kujdesur vecanerisht që instalimi i kutive të mesiperme të bëhet rrafsh me murin në lidhje me sipërfaqet e suvatuar dhe të veshura, në mënyrë që të mos verifikohen dalje apo futje të tepërta të këtyre kutive.

Instalimet elektrike të fuqisë dhe sinjalizimit që kalojnë në dyshemë bëhen me tub të rende, kurse ato që kalojnë në mure dhe tavane janë të serisë së lehtë. Tubat e dyshemëve janë vendosur në shtresat e dyshemëve dhe në mure brenda suvase dhe bëhen para se muret të suvatohen.

Tubat duhet të jenë të gjithë të pa djegëshme

Projekti parashikon mbrojtjen diferenciale me rele diferenciale 0.03A $R_t < 4$ dhe mbrojtjen nga LSH me automat termoelektromagnetik.01.

Linjat e furnizimit janë me tre percjelles (kafë = fazë, blu = nul, e verdhe = tokëzim).

Karakteristikat e automateve duhet të zbatohen rigorozisht sipas klasit A. B. C. D. (karakteristika termike e momentit të inercisë) për të garantuar selektivitetin.

Percjellesit që do të përdoren do të jenë fleksibel antifiam.



Instalimi i elementeve do te behet si me poshte:

1.1 UPS, S=10kVA "Online", 30min Autonomi

Domosdoshmëria e instalimit të grupeve të tilla, shpjegohet me faktin se të gjithë sistemet e rrymave te dobëta, mbeten të pafurnizuara me energji për një kohe (10-15)sek, aq sa është edhe koha e futjes në funksionim e grupit motogjenerator. Në rastet e ndërprerjes të furnizimit (black out), pajisja UPS ushqen menjëherë konsumatorët e lidhur me te, duke lejuar ushqimin e tyre nëpërmjet baterive të akumulatorëve, që janë pjesë perberese e UPS.

Nga ky UPS do te furnizohen postet e punes tek koka e krevatit te pacientit, prizat e psoteve te punes ne dhomat sic trgohet ne projektin e rrjetit te fuqise, grupi i ndricuesve te emergjences, grupi i ndricuesve te evakuimit EXT, te gjithe konsumatorët elektrike brenda rackut, si edhe paneli i alarmit te zjarrit.

Ky UPS se bashku me dollapin e baterive do te jete trefazor, 400 V, 10 kVA, me by-pass operacional dhe mirembajtje, me autonomi te baterive 30min dhe koeficient filtrimi $\leq 2\%$ dhe specifikimet qe duhet te plotesoje pikat e mëposhtme:

Në hyrje (Input):

- Tensioni i rrjetit: $U=400V$; 3P +Neuter
- Frekuenca nominale: $f=50\text{ Hz}$;
- Luhatjet e tensionit: $\pm 15\%$;
- Qëndrueshmëria $I_{CC} = 25kA$;
- Distorcionet harmonike të rrymës: 2% ;
- Koeficienti i fuqisë: $0,9$;
- Tensioni i baterive: $110V\text{ (DC)}$;
- Me by-pass operacional;
- Pavaresi e baterive 30min.
- Online

Në dalje (Output):

- Fuqia nominale: $S=10\text{ kVA}$;
- Tensioni i daljes: $400,3P + N$;
- Stabiliteti statik i tensionit: $\pm 1\%$;
- Stabiliteti mekanik i tensionit: $\pm 3\%$ (brenda 2 msec);
- Frekuenca: $f=50\text{ Hz}$;
- Stabiliteti i frekuencës: $\pm 0,5\%$ (për mungese rrjeti);
- Autonomia: 30minuta;
- Forma e kurbes së tensionit: sinusoidale;
- Qëndrueshmëria ndaj mbingarkesave për $1,5 \times I_n$ jo me pak se 30 sekonda;
- Koeficient filtrimi: $\leq 2\%$;
- Rendimenti: $0,9 - 0,94$;
- Niveli i zhurmave: $52-4,6\text{ dB}$ (ne varësi të ngarkesës);
- Temperatura e punës: $0 - 40^\circ$;



2. Furnizimi me energji i objektit

2.1 Linjat e jashtme e furnizimit me energji e objektit

Furnizimi i zones te me energji elektrike perbehet nga nje burim ushqimi qe vjen nga paneli elektrik ne katin perdhe te spitalit rajonal vlore. Ne projektin elektrik eshte parashikuar qe linja e jashtme e furnizimit me energji do të jete kabllore, me izolim XLPE/EPR, tip FG7(O)M1 me seksion $S = 3 \times 70 + \text{mm}^2$.

2.2 Automatet mbrojtës

Pajisjet mbrojtëse duhet të jenë automatë sipas normës CEI 60898 dhe CEI 60947-2. Këta automatë mbrojnë pajisjet dhe sigurojnë një veprim të shpejtë nga mbingarkesa dhe lidhjet e shkurtra. Këta automatë duhet të lidhen para pajisjeve fundore dhe qarqeve te cilat nuk kanë prezencë direkte të personelit.



Figura 4 : Automatë një dhe dy polarë sipas CEI 60898

Karakteristikat e automatëve:

- Rryma e lidhjes shkurtër: 6 kA;
- Rryma nominale: 6 – 32A;
- Tensioni nominal i punës: 230V;
- Numri i cikleve: 20 000.



Figura 5 : Automatë dy polarë sipas CEI 60947-2



"6D-PLAN" sh.p.k.

NIPT: L62717405H

Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla 3, Kati i Parë, Njësia Nr.7, Tiranë

E-mail: 6d.plan@gmail.com, Nr tel : + 355 456 29 711, Mob: + 355 69 60 66 450

Karakteristikat e automatëve:

- **Rryma e lidhjes shkurtër:** 6-10 kA
- **Rryma nominale:** 10-63A
- **Tensioni nominal i punës:** 230V
- **Karakteristika e rënies:** "C"
- **Numri i cikleve:** 10 000 - 20 000

Automatët diferencialë dhe MT diferencialë sipas normës CEI 61008, sigurojnë përvec mbrojtjes nga mbingarkesa dhe lidhjet e shkurtra edhe mbrojtjen nga rrymat e rrjedhjes me tokën. Në këtë mënyrë sigurojnë personelin nga ndonjë gabim i mundshëm gjatë instalimit dhe gjatë dëmtimit të pajisjeve të cilat kanë kontakt direkt me të. Në mënyrë kategorike të gjitha qarqet e mësipërme duhet të mbrohen me automatë diferencialë



Figura 6 : Automatë diferencialë dy polare dhe katër polare sipas CEI 6100

Karakteristikat e automatëve diferenciale:

- **Rryma nominale:** 25 - 100A;
- **Tensioni nominal i punës:** 230/400V;
- **Karakteristika e rënies:** "C";
- **Numri i cikleve:** 2500;

Automatët e fuqisë sipas normës CEI 60947-2 të përshtatshëm për panelet TU si ata kryesore ashtu edhe ata shpërndarës të kateve. Sigurojnë dhe garantojnë furnizimin me energji të të gjithë objektit dhe mbrojnë gjithë panelin dhe instalimin nga lidhjet e shkurtra dhe nga mbingarkesat. Këta automatë janë me mbrojtje termike nga mbingarkesat të rregulleshme. Në të gjitha rastet kur ngarkesat e llogariura e kalojnë rrymen 80A duhet të përdoren automatë si figuren e mëposhtme.



Figura 7 : Automatë magnetotermikë LSI dhe LSIG, tre dhe katër polare sipas CEI 60947-2, te përdorur ne kompozimin e Panelit Elektrik Kryesor dhe Panelin Elektrik Shpërndarës

Karakteristikat e automatëve magnetotermikë:

- **Rryma nominale:** 80 - 250A;
- **Tensioni nominal i punës:** 380/415V;
- **Karakteristika e rënies:** "C";
- **Tarimi i rymës termike:** $(0.7 - 1) \times I_n$;
- **Numri i cikleve mekanikë:** 40 000;



"6D-PLAN" sh.p.k.

NIPT: L62717405H

Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla 3, Kati i Parë, Njësia Nr.7, Tiranë

E-mail: 6d.plan@gmail.com, Nr tel : + 355 456 29 711, Mob: + 355 69 60 66 450

- **Numri i cikleve elektrike:** 20 000;

Pajisjet mbrojtëse nga mbitensionet sipas normës CEI 61643, shërbejnë për të mbrojtur sistemin elektrik nga mbitensione të paparashikuara të ndodhura nga goditjet e rufeve apo edhe të atyre goditjeve që vijnë nga vetë rrjeti shpërndarës OSHEE gjatë komutimeve të ndryshme dhe gjatë defekteve të rënda në pajisjet transformuese.



Figura 8 : Shkarkues nga mbitensioni një dhe tre fazore sipas CEI 61643

Karakteristikat e shkarkuesve nga mbitensioni:

- **Tensioni nominal i punës:** 230/400V;
- **Frekuenca:** 50Hz;
- **Fuqia c'kycjes:** 25kA;
- **Koha veprimit:** 25ns;
- **Temperatura punës:** -25, +60C;

Pajisjet matëse sipas normës CEI 60051 shërbejnë për një kontroll të thjeshtë të parametrave të sistemit elektrik. Të domosdoshme gjatë mirëmbajtjes si dhe për eliminim sa më të shpejt të defekteve, këto pajisje ndihmojnë personelin teknik të shërbimit të veprojnë shpejt në rast defekti të mundshëm dhe të vërojnë në mënyrë periodike të dhënat bazë të rrjetit elektrik si rryma dhe tensioni.

Për personelin e kualifikuar, për kontrollin dhe matjen e saktë të konsumit të energjisë dhe për vërtetimin e parametrave specifikë si koeficienti i fuqisë të përdoren pajisje sipas normës IEC 62053-21 si në figurë. Këto pajisje sigurojnë një cilësi të matjes së energjisë aktive në shkallën 1 dhe të energjisë reaktive në shkallë 2.



Figura 91 : Pajisje matëse digitale sipas për matjen e të gjithë parametrave të rrjetit IEC 62053-21



"6D-PLAN" sh.p.k.

NIPT: L62717405H

Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla 3, Kati i Parë, Njësia Nr.7, Tiranë

E-mail: 6d.plan@gmail.com, Nr tel : + 355 456 29 711, Mob: + 355 69 60 66 450

Karakteristikat e pajisjeve matëse digjitale:

- **Tensioni nominal i punës:** 230/400V;
- **Frekuenca:** 50Hz
- **Klasa saktësisë për rymën:** 0.5%;
- **Klasa saktësisë për tensionin:** 2%;
- **Klasa saktësisë për energjinë:** 2%;
- **Komunkimi:** MODBUS, RS485

Pajisjet komutuese sipas normës CEI 60947-3 si në figurën 10, janë ato pajisje të cilat bëjnë të mundur takimin apo stakimin e ngarkesës por nuk mund ta mbrojnë rrjetin nga lidhjet e shkurtra e mbingarkesa. Këto nuk janë pajisje mbrojtëse dhe detyrimisht duhet të shoqërohen me automatë ose të përdoren për pajisje dhe qarqe të cilat janë të mbrojtura në vetëvehte. Kanë vecorinë e kostos së ulët, lehtësisë së veprimit dhe shpejtësisë së hapjes dhe mbylljes.



Figura 10 : Pajisje komutuese sipas normës CEI 60947-3

Karakteristikat e komutatorëve:

- **Rryma nominale:** 40 - 250A;
- **Tensioni nominal i punës:** 380/415V;
- **Numri i cikleve mekanike:** 20 000;
- **Numri i cikleve elektrike:** 1 500;
- **Modulare deri ne:** 80A.

2.3 Rrjeti ushqyes

Me rrjet ushqyes nënkuptojmë linjat që nisen nga panelet qendrore të T.U.- 0,4 KV dhe përfundojnë në kuadrot lokale të kateve apo mjediseve të veçanta. Ne përputhje me normat VDE, IEC dhe CEI kap. VI linjat ushqyese (si dhe ato shpërndarëse) duhet:

- Te zgjidhen: Sipas kushteve të ngrohjes nga rrymat e punës;
- Te kontrollohen: Ne humbje tensioni

Per mbingrohje nga R.L.SH. Interruptoret (automatet) magnetotermike të çilet instalohen për të mbrojtur rrjetat ushqyese dhe ato shpërndarëse duhet të plotësojnë kushtet që pasojnë:

Kushti 1: $I_b \leq I_n \leq I_z$

Kushti 2: $I_f \leq 1,45 I_z$

- I_n – rryma nominale e automatit (A)
- I_b – rryma e punës (llogaritëse) në A



- Iz – rryma e lejuar e përcjellësve apo kablllove (korrigjuar sipas gjithë koeficienteve përkatës K1 deri K8 të mënyrës së vendosjes, temperaturës së ambientit, etj.)

Kushti 3: Sipas normave VDE dhe CEI 64 – 8-automatet magnetotermike duhet të plotësojnë:

$$I^2 \times t \leq K^2 \times S^2$$

Kjo do të thotë që automatet duhet të kenë aftësinë çkyçëse më të madhe se sa vlera e RLSH të llogaritur në piken ku instalohen këta automate. Te gjithë fiderat e paneleve (power center) duhet të pajisen edhe me rele diferenciale të regullueshme si për sa i përket vleftës së rrymës ashtu edhe kohës së veprimit. Ne çdo rast duhet të behet kujdes i veçantë për të plotësuar kudo kushtet e selektivitetit.

2.4 Norma te rrjetit shperndares te grupeve

- Te gjithë grupet e ndriçimit dhe prizave do të mbrohen me automate magnetotermike dhe shkeputes diferencial 30 mA;
- Seksioni i percjellsave të linjave te ndriçimit nuk do të jete me i vogel se seksioni $S=1,5 \text{ mm}^2$ prej bakri. Automatet magneto-termike do të jene 10 A me fuqi maksimale të çdo grupi monofazor jo me shume se 1500 W;
- Seksioni i percjellsave të prizave, që do të përdoren për ndriçim lokal të vendeve të punës gjithashtu do të jene $1,5 \text{ mm}^2$ prej bakri. Automatet njëlloj si pika b me sipër;
- Prizat për aparaturat e ndryshme elektrike të zyrave me fuqi më të vogël ose të barabarte me 2600 W, do të jene me seksion $2,5 \text{ mm}^2$ /baker kurse mbrojtja përkatëse 16 A;
- Për konsumatorët e veçantë me fuqi mbi 3600 W seksionet e percjellesave duhet të merren 4 mm^2 , kurse mbrojtja të jete 25 A;

2.5 Kanalet dhe aksesoret

Aksesoret e instalimeve nen suva jane:

- Tubat fleksibel PVC te dimensioneve te ndryshme ne varesi te dimensionit dhe te numrit te telave/kabllove qe do te futen ne te.
- Kutite per fiksimin e prizave ose te çelesave. Te gjitha keto vendosen para se te behet suvatimi.

Figure 22 : Detaj i instalimit te kanalave metalike te kalimit te kablove elektrike ne korridor




Figure 33 : Detaj i teknike te kanalave metalike te kalimit te kablove elektrike ne koridore




Figure 43 : Detaj i teknike te kanalave metalike te kalimit te kablove elektrike ne koridore

Per kryerjen e instalimeve elektrike te futura nen suva duhet te ndiqet rradha e punes si me poshte:

- Hapja e kanaleve ne mur me dimension te tille qe te vendoset lirshem tubi fleksibel dhe me thellesi te tille qe te mos dale mbi nivelin e suvase perfundimtare.
- Vendosen tubat fleksibel dhe kutite prej PVC te cilet provizorisht fiksohen me allçi (me vone mbyllen kanalet me llaç suvatimi)
- Pasi eshte kryer suvatimi, futen percjellesat ose kabllot, me ane te udhezuesit te tyre, te cilat duhet te hyjne lirshem dhe te lihet ne te dy krahet nje sasi e mjaftueshme per kryerjen e lidhjeve dhe montimeve te tyre sipas kushteve teknike te instalimit.



"6D-PLAN" sh.p.k.

NIPT: L62717405H

Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla 3, Kati i Parë, Njësia Nr.7, Tiranë

E-mail: 6d.plan@gmail.com, Nr tel : + 355 456 29 711, Mob: + 355 69 60 66 450

- Kanalet dhe vendosja e tubave fleksibel PVC duhet te behet ne distance 0.4 m me poshte nga niveli i tavanit ne vije te drejte horizontale dhe zbritjet per çesesa ose prizat te behen vertikale te drejta dhe jo me kend ose ne forme harku.
- Kutite shperndarese ne varesi te sistemit qe do te perdoret jane per nen suvatim ose mbi suvatim keshtu qe menyra e fiksimit te tyre eshte ose me allçi ose me ane te vidave me upa.
- Permasat e kutive shperndarese variojne sipas rastit dhe nevojës. Ato jane ne forme rrethore, katrore ose drejtkendeshe dhe kapaket e tyre mbylles fiksohen me vida.

E rendesishme eshte qe lidhja e telave/kabllove brenda ne kutite shperndarese te realizohet me ane te klemeve bashkuese/ kapucave lidhes, dhe jo me nastro. Sistemi i kanalinave ashtu si sistemi nen suva me tuba fleksibel duhet te plotesoje te gjitha kushtet teknike te instalimeve elektrike.

Impianti elektrik duhet te zbatohet sipas :

- permasave, markes, karakteristikave dhe cilesise se materialit te treguar ne projektet e hartuara;
- udhezimeve te D.R. gjate kryerjes se puneve ;
- rispektimit te ligjeve ne fuqi ;

Materialet dhe aparatet qe duhet të përdoren ne ndertimin e impiantit duhet te kene te gjitha cilesite e fortesise, kohezgjatjes, izolimit dhe të funksionimit te mire; dhe duhet gjithashtu te jene te tilla qe ti rezistojne veprimeve mekanike, gerryese, termike dhe lageshtires per ato qe duhet te jene ne kontakt me te gjate punes. Gjithashtu, jane nen pergjegjesine e sipermarresit montimet dhe cmontimet përkatëse te pjesëve te instalimit per realizimin e provave dhe të verifikimeve.

Te gjitha aparatet, kuadrot, centralet e inkasuar, çelësat, butonat, prizat etj., duhet te vendosen në vepër nepermjet kutive te instaluara me Llaç çimentoje m-1:2, me dozim per m2: çimento 400 kg 527, rërë e lare m3 0.89 dhe uje, duke u kujdesur vecanerisht qe instalimi i kutive te mesiperme te behet rrafsh me murin ne lidhje me siperfaqet e suvatuara dhe të veshura, ne menyre qe te mos verifikohen dalje apo futje te teperta te ketyre kutive.

Tubot PVC fleksibel duhet te jete i nderfutur ne kutite, qe permbajne celesat ose prizat, qe ne asnje menyre te mos demtoje qe hyjne ne kuti. Eshte absolutisht i ndaluar perdorimi i llaçit me allci ose i lendeve te tjera te ngjashme per vendosjen në vepër te kutive, mbylljen e kanaleve te hapura dhe të çdo punimi tjeter ne murature te nevojshem per impiantin.

2.6 Rrjeti i Kablo te Fuqise

Kabllo e përdorur do të jenë të tipit FG7(O)R, FG7(O)M1 dhe FTG10(O)M1, sipas normës CEI 20-20, Classe 5, me cilësi të larta antizjarr dhe pa gazra toksike sipas normës CEI 20-38. Gjithashtu do te perdoren edhe percjelles N07V-K per shperndarjen e linjave nga kutite shperndarese ne kutite e celesave te ndricimit.





Figura 52 : Kabllo multipolar te tipit FG7(O)R

Figura 63 : Percjelles te tipit N07V-K

Përshkrim i përgjithshëm për kabllo FG7(O)R

Kabllo FG7(O)R është kabllo HEPR fleksibël, i izoluar, me mburojë të endur, të përbërë prej percjellësish me bakër të kuq, me mbrojtje PVC, antikorroziv dhe pa halogjen. Është i përshtatshëm për transmetimin e fuqisë dhe kontrollin e fuqisë në industri dhe ndërtim. I përshtatshëm për instalime fikse të brendshme dhe të jashtëme, instalime në ura, në tuba, etj.

Specifikime teknike:

- Tensioni nominal: U_0/U : 0,6/1kV;
- Tensioni maksimal U_m : 1200V;
- Temperatura maksimale operative: +90°C;
- Temperatura maksimale e qarkut të shkuter: +250°C;
- Fleksibiliteti: Classe 5.

Mbeshtetur ne Standartet:

- CEI 20-13, CEI 20-11, CEI 20-29, IEC 60502-1, CEI UNEL 35375, CEI UNEL 35377 - Konstruksioni dhe kërkesat.
- CEI 20-22 II, CEI EN 60332-1-2 – Cilesi të larta antizjarr.
- CEI EN 50267-2-1 – Antikorroziv.

Ngarkesa e llogaritur për kabllot e mësipërm duhet të repektojnë kushtin:

- Për kabllot 1-6mm² dendësia mesatare e rrymës 4A/mm²;
- Për kabllot 6-16mm² dendësia mesatare e rrymës 2-4A/mm²;
- Për kabllot >16mm² dendësia mesatare e rrymës 1-2A/mm²;

Kabllo FTG10(O)M1:




Figura 7 : Kabllo multipolar te tipit FTG10(O)M1

Specifikime teknike për kabllot FTG10(O)M1 0.6/1kV:

Percjellesi: Percjellesi bakri fleksibel ne baze te standartit IEC 60228

Izolimi : gome, tipi G10

Mbeshtjellja e jashtme: johalogjen, blu RAL 5012

Tensioni nominal: 0.6/1kV

Diapazoni i temperaturave: -25°C deri ne +90°C

Mbeshtetur ne standartet:

- EN 50266 / IEC 60332-3-24 / CEI 20-22III
- EN 50267-2-1 / IEC 60754-1 / DIN VDE 0482 part.267-2-1
- IEC 60331 / EN 50200



Markat e kablllove do të jene të tipit FG7(O)R, per linjat e fuqise dhe ndricuesve normal dhe te emergjences me durueshmeri kundra zjarrit prej 3 oresh me izolacion PVC. Dejet e kablllove do të jene me ngjyra të veçanta dhe standarde (percjellesi i nudit me ngjyre blu, percjellesi i tokezimit ngjyre verdhe-jeshile). Në kabllot trefazore duhet të jene të dallueshme edhe ngjyrat e fazave si edhe toka.

Duke zbatuar këto kushte për ngarkesat në sistemin e fuqisë kabllot do të shfrytëzohen për kohë të gjatë dhe instalimi i tyre do të ketë garancinë dhe jetëgjatësinë e kërkuar. Rrjeti shpërdarës do të përbëhet nga paneli kryesor i cili duhet të vendoset në dhomën teknike dhe nga panelet e kateve. Në secilin panel elektrik do të vendosen pajisje mbrojtëse, pajisjet matëse dhe ato komutuese, të cilat do të bëjnë mbrojtjen, matjen dhe komutimin e konsumatorit.

Kudo që do të shtrihen ura kablllore apo kanalino, kabllot do shtrihen brenda tyre. Atje ku mungojnë urat apo kanalinet murale apo nene dysheme, shtrirja e kablllove të rrjetit shpërndarës do të behet me tuba TVC pesante veteshues të tipit me përbërje dielektrike RK15.

2.7 Seksioni i percjellesit te Nudit

Percjellesat e nudit duhet të kenë seksion më të vogël se seksioni i fazave. Për kabllot me seksion $> 16 \text{ mm}^2$, seksioni i nudit sipas CEI mund të reduktohet deri në gjysmen e seksionit të fazave. Sipas VDE seksioni i nudit duhet gjithmonë (pavarësisht nga seksioni i fazave) i njëlojtë me atë të fazave.

3. Sistemi i Rrjetit te Fuqisë

Persa i perket sistemit te prizave te fuqise ato jane vendosur ne vizatime mbeshtetur ne planimetritë dhe arredimin e brendshem te ambienteve. Ato duhet te kene montim rafsh dhe duhet te kene nje ngjyre qe te shkoje me kapaket e çelesave te ndriçimit. Ky sistem është vendosur ne te gjitha ambientin e magazines.

Te gjitha prizat jane 230V, 16A, me tokëzim, industriale, per montim jashte murit IP55. Instalimi nga kuadrot e shperndarjes deri tek kutia shperndarese te prizave do te behet me kabell FG7(O)R me $S=3 \times 2.5 \text{ mm}^2$ te futur ne tubo metalik $d=20 \text{ mm}$.

Instalimet elektrike te fuqise dhe sinjalizimit qe kalojne ne dysheme behen me tub te rende, kurse ato qe kalojne ne mure dhe tavane jane te serise se lehte. Tubat e dyshemese jane vendosur nen shtresat e dyshemese dhe ne mure brenda suvase dhe behen para se muret te suvatohen. Tubat duhet te jene te gjithë te pa djegeshme. Projekti parashikon mbrojtjen diferenciale me rele diferenciale 30mA. $R_t < 3 \Omega$ dhe mbrojtjen nga LSH me automat termoelektromagnetik.

Linjat e furnizimit jane me tre percjelles dhe karakteristikat e automateve duhet te zbatohen rigorozisht sipas klasit A. B. C. D. (karakteristika termike e momentit te inercise) per te garantuar selektivitet. Percjellesit qe do te perdoren do te jene fleksibel antifiam.

Instalimi i elementeve do te behet si me poshte:

- Lartesia e çelsave do te jete 110 cm nga dyshemeja.
- Lartesia e kutive shperndarese 20 cm nga dyshemeja.
- Lartesia e prizave do te jete 30cm nga dyshemeja.



Persa i perket sistemit te prizave te fuqise ato jane vendosur ne vizatime mbeshketur ne planimetrit dhe arredimin e brendshem te magazines. Te gjitha prizat jane te tipit shuko dhe te pajisura me tokezim.

4. Sistemi i Ndricimit Normal

Pavaresisht ambjentit i cili do te ndricohet llogaritja e ndricimit eshte bere sipas normes UNI EN 12464 duke krijuar nje siperfaqje uniforme te ndricuar mire ne cdo pjese te saj dhe te qete per punen e personelit dhe te gjithë njerezve. Ndricimi eshte projektuar sipas tipologjisë së ambjenteve duke plotësuar kushtet dhe normat mbi llojin e ndricimit, niveleve të ndricimit dhe rezikshmërinë e instalimit të ndricimit.

Sipas standartit european te ndricimit EN 12464, eshte respektuar me rigorozitet fuqia e ndricmit sipas ambjenteve si me poshte:

▪ Dhome pacientesh	300lux
▪ Dhome monitorimi	300lux
▪ Garderobe	200lux
▪ Dhome mjeku	500lux
▪ Dhome kryeinfermieri	500lux
▪ Dhome infermieri	500lux
▪ Dhome medikamenti	200lux
▪ Dhome mbledhje	300lux
▪ Tualete	200 lux
▪ Korridor	200lux

Për ndricimin e objektit eshte projektuar i gjithë rrjeti i ndricimit dhe sipas tipologjise se ambienteve jane vendosur keto tipe ndricuesisht :

- a. Tipi i ndricuesit te perdorur ne ambientet e dhome pacientesh, eshte tip panel LED, tip 60x60cm, 40W, IP-40, 4000K :



Figura 8 : Ndricues kator panel LED 39W, 60x60cm, IP54, me difuzor mikroprizmatik, inkaso i perdorur ne ambientet dhomes te pacientit 3 te reaminacionit



"6D-PLAN" sh.p.k.

NIPT: L62717405H

Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla 3, Kati i Parë, Njësia Nr.7, Tiranë

E-mail: 6d.plan@gmail.com, Nr tel : + 355 456 29 711, Mob: + 355 69 60 66 450




Figura 9 : Kurba fotometrike e ndricuesit katror panel LED 39W, 60x60cm, IP54, me difuzor microprizmatik
Specifikimet teknike te ndricuesit katror panel Led 39W, 60x60cm, IP54:

- **Montimi:** Inkaso i instaluar ne tavan
- **Burimi i drites :** LED;
- **Sistemi optik :** difuzor mikroprizmatik;
- **Sistemi i ndricimit:** Direkt;
- **Instalimi :** me kitin e transformatorit AC/DC;
- **Ushqimi :** 220-240 V, 50-60 Hz;
- **Fuqia Instaluar :** 1x39W;
- **Fluksi i ndricimit** 3350lm;
- **Shkalla e mbrojtjes :** IP 54;
- **Klasa mbrojtjes mek:** IK 07;
- **Pesha ndricuesit :** 9.6kg;
- **Dim. (LxWxH) :** (605x605x101)mm ;
- **Siperf.perfunduar :** White RAL 9003 (W03);
- **Sistemi Efikasitetit:** 86lm/W
- **Indeksi I ngjyres :** CRI(Ra) 80+
- **Ngjyra e tempera:** 4000K
- **Kendi i rrezes:** 60°
- **Temp. Punes:** -20°C ne +35°C
- **Jetegjatesia:** 50,000 ore pune, me eficence te larte.

- b. Tipi i ndricuesit te perdorur ne ambientet garderobe (1), dhome monitorimi (2), Dhome mbledhje (4), korridore (5), dhome mjeku shefi (9), dhome personeli (10), dhome krye-infermieri (12), dhome mjeku (13), dhome medikamenti (14), dhome infermieri (15), holl pritje (16), eshte tip panel LED, tip 60x60cm, 40W, IP-40, 4000K :



"6D-PLAN" sh.p.k.

NIPT: L62717405H

Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla 3, Kati i Parë, Njësia Nr.7, Tiranë

E-mail: 6d.plan@gmail.com, Nr tel : + 355 456 29 711, Mob: + 355 69 60 66 450



Figura 10 : Ndricues LED 39W, 60x60cm, IP54 inkaso i perdorur ne ambientet e korridoreve




Figura 11 : Kurba fotometrike e ndricuesit LED 33W, 60x60cm, IP54

Specifikimet teknike te ndricuesit Panel Led 33W, 60x60cm, IP54:

- **Montimi:** Inkaso i instaluar ne tavan
- **Burimi i drites** : LED;
- **Sistemi optik** : difuzor opal;
- **Sistemi i ndricimit:** Direkt;
- **Instalimi** : me kitin e transformorit AC/DC;
- **Ushqimi** : 220-240 V, 50-60 Hz;
- **Fuqia Instaluar** : 1x33W;
- **Fluksi i ndricimit** : 3850lm;
- **Shkalla e mbrojtjes** : IP 54;
- **Klasa mbrojtjes mek:** IK 07;
- **Pesha ndricuesit** : 8.1kg;
- **Dim. (LxWxH)** : (605x605x101)mm ;
- **Siperf.perfunduar** : White RAL 9003 (W03);
- **Sistemi Efikasitetit:** 96lm/W
- **Indeksi I ngjyres** : CRI(Ra) 80+
- **Ngjyra e tempera:** 4000K
- **Kendi i rrezes:** 60°
- **Temp. Punes:** -20°C ne +35°C
- **Jetegjatesia:** 50,000 ore pune, me eficence te larte



c. Ndricues per tualetet 1x20W, IP44



Figura 29: Ndricues spot LED 1x20W, IP-44

Specifikime teknike te ndricuesit:

- **Montimi:** I montuar ne tavan
- **Burimi i drites:** LED;
- **Ushqimi :** 220-240 V, 50-60 Hz;
- **Fuqia Instaluar :** 1x20W;
- **Fluksi i ndricimit** 2200lm;
- **Shkalla e mbrojtjes :** IP 65;
- **Dim. (LxWxH) :** Ø115mm
- **Siperf.perfunduar :** White RAL 9003 (W03);
- **Indeksi i ngjyres :** 80 Ra
- **Ngjyra e tempera:** 4000K
- **Jetegjatesia:** 40,000 ore pune, me eficence te larte.

I gjithë rrjeti i ndricimit do të behet me kabllo FG7(O)M1 me seksion $S=3 \times 1.5 \text{ mm}^2$. Te gjitha urat lidhese ndermjet ndricuesve do të realizohen me kabllo FG7(O)M1 me seksion $S=3 \times 1.5 \text{ mm}^2$. Vendodhja e çelesave të ndricimit tregohet sipas projektit elektrik projektues. Në përgjithësi çelesat e ndricimit gjatë gjithë ndertesës duhet të jenë të përshtatshme për montim të rrafshet (nën suvatim). Te gjithë çelesat duhet të kenë një shkallë minimale prej 10-16A.

